



**mehr Sprache.**  
Kanton St.Gallen

# Fol me mua dhe më dëgjo!

## **12 udhëzime**

se si mund t'i ndihmojmë fëmijët tanë  
kur mësojnë të folurit

## **Një broshurë për prindër**

Shqip

**0-4**  
vjeç

# Të dashur prindër,

urime të përzemërta për lindjen e fëmijës tuaj. Koha e gjatë e pritjes mbaroi. Më në fund mund ta mbani fëmijën tuaj në krahë. Ju keni marrë me siguri shumë urime nga të afërmit, të njohurit dhe nga rrethi i miqve. Me këtë rast mbase e keni pyetur veten herë pas here, se si do të jetë rruga jetësore e fëmijës suaj dhe se si mund ta shoqëroni atë më së miri.

Ju si prindër për fëmijën tuaj doni më të mirën. Por shpesh në çështje edukimi njeriu gjendet përpara sfidave të reja, nganjëherë ndihet paksa i mbingarkuar kur bëhet fjalë për marrje vendimesh për të mirën e fëmijës. Kështu u ndodh shumë prindërve.

Me anë të kësaj broshure ne duam t'ju ndihmojmë në një çështje të rëndësishme. «Fol me mua dhe më dëgjo!» ka si qëllim t'ju informojë se si ta ndihmoni mirë fëmijën tuaj në vitet e para të jetës që të mësojë të flasë.

Vitet e para të jetës janë një periudhë shumë e rëndësishme për zhvillimin gjuhësor të një njeriu, dhe ju si prindër mund ta përkrahni mirë fëmijën tuaj në mësimin e të folurit dhe në mësimin e gjuhës. Zotërimi i mirë i gjuhës dhe i gjuhëve, sot dhe në të ardhmen, është i rëndësishëm për jetën në shoqërinë tonë dhe për një ekzistencë të mirë profesionale.

Nëse ju vetë nuk jeni rritur me gjuhën gjermane, ose e keni mësuar gjermanishten vetëm në moshën madhore, e pyesni ndoshta veten, si mund ta përkrahni mirë fëmijën tuaj në mësimin e të folurit. Për këtë qëllim në broshurën tonë do të gjeni mjaft informacione të dobishme, - edhe me shembuj praktikë -, se si mund të rriten fëmijët kollaj me dy ose edhe më shumë gjuhë.

Të përkrahësh fëmijët në mësimin e të folurit nuk është një vepër arti. Këtë do ta mësoni, sapo ta lexoni këtë broshurë. Mirëpo kjo kërkon vëmendjen dhe aktivitetin tuaj. Prandaj mos e lexoni vetëm një herë këtë broshurë. Le të jetë ajo një shoqëruese e juaja. Ju do të zbuloni vazhdimisht gjëra që do t'ju ndihmojnë për një përkrahje të mirë të fëmijës suaj në vitet e para të jetës.

**Shumë kënaqësi me fëmijën tuaj dhe gjithë të mirat ua dëshiron  
Qendra përgjegjëse për integrim dhe barazi e Kantonit të St.Gallenit**

## A e keni ditur se ...

mund të nxisni qysh gjatë shtatzënisë një zhvillim të mirë gjuhësor të fëmijës suaj?

# 1. Tung, ju nuk më shihni dot mua, por unë mund t`ju dëgjoj!

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë fakt?

- Qysh pas muajit të 4-të të shtatzënisë fëmija fillon të perceptojë zëra; para së gjithash zërin e nënës.
- Melodia gjuhësore e gjuhës së nënës ngulitet tek fëmija qysh para lindjes. Edhe muzika dhe zhurmat ndikojnë qysh në barkun e nënës.
- Në vitet e para të jetës prindërit janë shembujt më të rëndësishëm për fëmijën e tyre. Për këtë shkak është e rëndësishme, që qysh gjatë shtatzënisë të mendohet për faktin, se në cilën gjuhë, ose ndoshta në cilat gjuhë, duan që prindërit të flasin me fëmijën e tyre.

# Këshilla për jetën e përditshme

## Çfarë mund të bëni konkretisht për fëmijën tuaj:


I flisni fëmijës tuaj qysh gjatë shtatzënisë për botën tuaj. Tregojini atij se çfarë ju ngacmon.

**Për të vendosur, se në cilën gjuhë (ose në cilat gjuhë) do të flisni në shtëpi me fëmijën tuaj, do t'ju ndihmojnë vrojtimet në vijim:**

Flisni me fëmijën tuaj në gjuhën, në të cilën ndiheni mirë dhe të cilën e zotëroni më së miri. Në këtë gjuhë mund t'i jepni fëmijës tuaj edhe thesarin gjuhësor më të madh. Me këtë do të vendosni një bazë të mirë për të gjitha gjuhët e tjera, që fëmija i juaj do të mësojë gjatë jetës së tij.

**Në rast se ju si prindër flisni mirë gjuhë të ndryshme, kjo do të ishte një situatë fillestare shumë e vlefshme për fëmijën tuaj. Atëherë secili nga prindërit mund të flasë gjuhën e tij më të fortë me fëmijën. Kështu fëmija i juaj do të ketë modele të mira gjuhësore në të dy gjuhët.**

Pavarësisht se për cilën gjuhë familjare do të vendosni, është shumë e rëndësishme që fëmija i juaj ta mësojë edhe gjuhën vendore, gjermanishten. Që të ndihet mirë këtu, ai ka nevojë për njohuri të mira të gjermanishtes, të gjejë shokë e shoqe dhe të fitojë një arsimim të mirë. Fëmija i juaj mund ta mësojë mirë gjermanishten, edhe nëse në jetën tuaj të përditshme në shtëpi flisni një tjetër gjuhë me të.



## **A e keni ditur se ...**

fëmija juaj do të mësojë më së shumti, nëse ju do të flisni me të në gjuhën që keni më për zemër?

# **2. Gjuha e mamit është OK! – Gjuha e babit është OK!**

## **Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë fakt?**

- Për zhvillimin e përgjithshëm dhe atë gjuhësor një marrëdhënie e mirë emocionale është një bazë me rëndësi. Një fëmijë mund ta ndjejë, nëse prindërit e tij flasin me të një gjuhë, në të cilën ata ndihen mirë dhe të sigurtë.
- Sa më mirë që prindërit të flasin gjuhën që transmetojnë, aq më mirë është kjo edhe për zhvillimin gjuhësor të fëmijës.
- Të flasësh mirë gjuhën e nënës tënde, është baza më e mirë për të mësuar gjuhë të tjera. Secila gjuhë përmban dije mbi botën, që ne ua transmetojmë fëmijëve me anë të gjuhës.

# Këshilla për jetën e përditshme

## Çfarë mund të bëni konkretisht për fëmijën tuaj:

Flisni me fëmijën tuaj në gjuhën ose në dialektin që zotëroni më mirë.

Flisni shumë me fëmijën tuaj, por i jepni edhe atij mjaft kohë për të folur.

**Tregimet, këngët ose lojërat e fëmijëve nga vendlindja juaj i tregojnë fëmijës diçka mbi veten dhe mbi prejardhjen tuaj. Kjo është e rëndësishme, sepse fëmijëve u duhen edhe këto rrënjë.**

I hapni fëmijës tuaj rrugë pozitive edhe për gjuhë të tjera. Shkoni përpara me një shembull të mirë!

Në rast se mbani një qëndrim pozitiv ndaj gjuhëve, ndaj mësimin të gjuhëve, ndaj kultivimit të gjuhës suaj dhe të gjermanishtes, kjo do të transmetohet edhe tek fëmija i juaj.

## **A e keni ditur se ...**

vetëbesimi është baza më e mirë për zhvillimin gjuhësor të fëmijës suaj?

# **3. Unë jam për t'u dashur ashtu siç jam!**

## **Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë fakt?**

- Për zhvillimin e tij dhe për mësimin e të folurit, një fëmijë ka nevojë veçanërisht për përkushtimin e prindërve. Ai duhet ta përjetojë dhe ta ndjejë, se ata e duan dhe e pranojnë, në mënyrë që ta zhvillojë vetëbesimin. Kjo energji është çelësi i zhvillimit të tij.
- Një fëmijë ka nevojë edhe për siguri. Ai duhet të dijë nëse prindërit për një çast nuk kanë kohë, përse ata në atë çast nuk e dëgjojnë dot, dhe kur mund t'i përkushtohen sërish. Ai do të dijë se përse një gjë duhet bërë ose nuk ka mundësi të bëhet.

# Këshilla për jetën e përditshme

## Çfarë mund të bëni konkretisht për fëmijën tuaj:

Jeta e përditshme ofron shumë mundësi për të komunikuar me fëmijën tuaj dhe për të marrë pjesë në biseda. Me këtë mund dhe duhet të filloni qysh ditën e parë të jetës.

**Tregojini atij, se çfarë po bëni në atë çast me të. Reagoni ndaj zërave të tij dhe ia shprehni gëzimin që po ju shkakton.**

Mos e mbani fëmijën tuaj me premtime për kohë të pacaktuar. Kjo e bën të pasigurt atë. Mbajeni premtimin që ia jepni.

Dëgjojeni fëmijën tuaj me vëmendje, flisni me të dhe lavdërojeni!

Lëreni fëmijën tuaj të tregojë se çfarë ka përjetuar.

Lëreni të flasë deri në fund dhe mos e ndërprisni.



## A e keni ditur se ...

për fëmijët nuk është mbingarkesë, në rast se rriten me dy ose më shumë gjuhë?

# 4. Në kokën time ka vend edhe për dy apo më shumë gjuhë!

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë fakt?

- Fëmijët mund të rriten pa probleme me dy ose më shumë gjuhë – miliona fëmijë jetojnë nëpër vende, ku në jetën e përditshme përdoren shumë gjuhë. Zhvillimi i fëmijës nuk pëson gjë për këtë shkak.
- Fëmijët me shumë gjuhë zhvillohen njësoj si edhe ata me një gjuhë – ndonëse në mënyra të ndryshme. Disa flasin herët, të tjerët më vonë, disa flasin shumë, disa më pak.
- Zhvillimi gjuhësor i fëmijës është dinamik. Fëmija është gjithnjë në udhëtim, mëson gjëra të reja dhe i integron të vjetrat. Përzierja e gjuhëve është e lidhur me këtë zhvillim.
- Vëmendja e shtuar dhe biseda me mjekun ose mjeken, me një ekspert ose një eksperte, është e arsyeshme vetëm atëherë kur fëmija për një kohë të gjatë nuk bën përparime ose ka ndërprerë të folurit.
- Kur fëmijët rriten me më shumë se një gjuhë, kanë nevojë për një përkrahje të vetëdijshme në të gjitha gjuhët. Prindërit mund të kontribuojnë shumë, në mënyra krejt të ndryshme, që fëmijët t'ia dalin mirë kësaj pune.

# Këshilla për jetën e përditshme

## Çfarë mund të bëni konkretisht për fëmijën tuaj:

E edukoni fëmijën tuaj në gjuhën tuaj amtare, për shembull shqip, turqisht, boshnjakisht /kroatisht /serbisht, kurdisht, rusisht, spanjisht ..., ndërsa gjuha e mjedisit është gjermanishtja? Atëherë ju vetë flisni sa më shumë në gjuhën tuaj me fëmijën. Mirëpo kultivoni kontakte edhe me familjet fqinje, në të cilat flitet gjermanisht. Mbështesni fëmijën tuaj që të gjejë shokë e shoqe gjermanishtfolëse. Dërgojeni fëmijën tuaj në një grup lojërash ose në kopsht. Kjo gjë nxit zhvillimin e tij. Sa më herët që të ketë kontakt me fëmijë gjermanishtfolës, aq më shpejt dhe më lehtë do ta mësojë gjuhën e dytë.

**Ju si prindër zotëroni shumë mirë dy gjuhë? Atëherë fëmija ka mundësinë të mësojë një «gjuhë të mamit» dhe një «gjuhë të babit». Të keni parasysh, se ka rregulla të qarta gjuhësore. Para së gjithash kjo është e rëndësishme për fëmijët e vegjël. Mami flet me të në «gjuhën e mamit» dhe babi në «gjuhën e babit». Kështu fëmija mund të bëjë lidhjen e një personi të caktuar me një gjuhë të caktuar. Kjo e ndihmon t'i rendisë gjuhët qartë në kokën e tij.**

Përdorimi i gjuhëve mund të renditet edhe sipas situatave: Në jetën e përditshme flitet njëra gjuhë, kurse gjatë ngrënies së darkës ose gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë ose edhe gjatë «tregimeve para gjumit» gjuha tjetër. Kjo mënyrë quhet «Krijimi i ishujve gjuhësorë».

Nëse fëmija juaj do të rritet me një, dy ose tri gjuhë, e rëndësishme për secilin rast është kjo që vijon: Flisni shpesh me fëmijën tuaj, jini dëgjues i mirë dhe i durueshëm dhe përgëzojeni atë!

## A e keni ditur se ...

vetëm fëmijët që dëgjojnë mirë mund të mësojnë edhe të flasin mirë? A e keni ditur, përpos kësaj, që një foshnje, kur i flitet me një zë më të lartë reagon më shpejt?

# 5. Fol me mua dhe më dëgjo!

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë fakt?

- Dëgjimi i mirë është parakusht për të folurit e mirë. Një foshnje e shëndetshme zakonisht pas gjashtë muajve duhet të fillojë të belbëzojë gjithnjë e më shumë, të imitojë tinguj dhe të «flasë» me veten, në të kundërtën, duhet kontrolluar edhe një herë aftësia e saj dëgjimore.
- Edhe foshnjat me dëgjim të dëmtuar në muajt e parë lëshojnë tinguj nga vetja, por më pas bëhen gjithnjë e më të heshtura.
- Të folurit me një zë paksa më të lartë rrit vëmendjen e foshnjës. Kështu mund të shpëtohet qysh herët një buzëqeshje e parë nga foshnja.

# Këshilla për jetën e përditshme

## Çfarë mund të bëni konkretisht për fëmijën tuaj:


Vëzhgojeni fëmijën tuaj para së gjithash pas muajit të 6-të të jetës. A i percepton dot zhurmat? A e kthen kokën kur e thërrisni?

Orët-lodra dhe rrake-taket janë veçanërisht të përshtatshme për të zgjuar vëmendjen e foshnjës.

## Flisni shpesh dhe shumë me foshnjën tuaj, dhe atëherë do ta vëreni nëse ju dëgjon mirë.

Imitoni tingujt dhe belbëzimin e foshnjës tuaj. Ndonëse akoma foshnje e vogël, tregojini se çfarë po bëni momentalisht me të. Të kënduarit dhe vjershat e rimuara pëlqehen tepër nga të gjithë fëmijët e të gjitha moshave.

Sidomos pas një infeksioni të veshëve të foshnjës ose të fëmijës së vogël duhet shkuar patjetër për kontroll: te konsultorja e nënave dhe etërve në komunën tuaj ose te mjeku ose mjekja e juaj.



## A e keni ditur se ...

gjuha mësohet me të gjitha shqisat? Jo vetëm dëgjimi është i rëndësishëm, por edhe prekja, shikimi, përvoja, marrja në dorë, ...

# 6. Unë e bëj vetë këtë!

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë fakt?

- Dëgjimi, shikimi, prekja, lëvizja, kuptimi, perceptimi i lëvizjeve, përjetimi i forcës së rëndësës dhe shumë të tjera, e ndihmojnë një foshnje të mësojë mbi botën dhe ta kuptojë atë. Kështu ai i zhvillon aftësitë e veta emocionale, mendore dhe sociale, por edhe gjuhën e tij.
- Foshnja e juaj e kupton çfarë do të thotë «e lëmuar» ose «e ashpër», nëse lejohet të kapë sende në dorë. Kuptimet «ëmbël» ose «thartë» i mëson, kur i lejohet të provojë ushqimet. Qoshet dhe këndet mund t'i vlerësojë, nëse lejohet të zvarritet. Kështu në kokën e tij krijohen konceptet mendore që lidhen me fjalët.

# Këshilla për jetën e përditshme

## Çfarë mund të bëni konkretisht për fëmijën tuaj:

Merreni foshnjën tuaj shpesh në krahë dhe  
lëreni fëmijën t'i ndjejë ledhatimet si diçka të  
këndshme.

Lëreni foshnjën tuaj të kapë në dorë sende,  
t'i mbajë ato fort dhe t'i lëshojë sërish!

Jepni foshnjës të kafshojë diçka! Mundësisht  
shumë gjëra lëreni t'i provojë vetë!

Kur të jetë pak më i rritur, lëreni fëmijën tuaj të  
provojë mundësisht shumë aktivitete: të zvarritet,  
të ecë në shtëpi, në sheshin e lojërave ose në  
oborr, të luajë me rërë dhe me ujë, të thërrasë dhe  
të këndojë, të ndihmojë në gatim, të shtrojë  
tavolinën, të gërmojë dheun në oborr, të mbjellë  
bimë. Kësisoj ai bëhet edhe qysh herët i pavarur.  
Më vonë kjo gjë do t'ia lehtësojë gjithashtu ditët  
e shkollës.

## A e keni ditur se ...

ekziston një varësi ndërmjet lëvizjes, lojës, të ushqyerit e shëndetshëm, dhëmbëve të shëndetshëm dhe zhvillimit gjuhësor të një fëmije?

# 7. Unë mund të bëj më shumë se sa mendoni ju!

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë fakt?

- Fëmijët kanë nevojë për përvojë në lojë dhe në lëvizje. Të nxisësh gjuhën do të thotë t'i mundësosh fëmijës shumë lëvizje. Duhet ta lini të hidhet, të kërcëjë, të ecë, të vrapojë, të vallëzojë... Gjuha dhe lëvizja shkojnë së bashku.
- Kur lëvizjet e fëmijës gjatë lojës, sidomos lëvizjet precize të gishtave, bëhen më të shkathëta, atëherë edhe lëvizjet e gojës dhe të gjuhës bëhen më të sakta.
- Një formë e rregullt e dhëmbëve është e rëndësishme, në mënyrë që fëmija të mësojë edhe të flasë saktë. Një shqiptim i qartë bën pjesë në njohuritë e mira gjuhësore.

# Këshilla për jetën e përditshme

## Çfarë mund të bëni konkretisht për fëmijën tuaj:

Lëreni fëmijën tuaj të ekuilibrojë mbi mure të ulëta, të hajë me gishta, të pijë me tuba të hollë, të fryjë pushin e luleve ... Dilni shpesh në sheshin e lojërave dhe në natyrë. Bëni punëdore me fëmijën tuaj dhe e lejoni të punojë me gërshërë. Gjersa jeni pranë tij, nuk mund t'i ndodhë gjë. Kështu fëmija mëson lëvizjet e sakta dhe mund ta zhvillojë fantazinë e vet.

**Fëmija i juaj nuk duhet të pijë pije të ëmbëlsuara.  
Prandaj mos e mësoni aspak me to!**

Tregoni kujdes për vendosje të rregullt të dhëmbëve. Për këtë shkak lëreni fëmijën tuaj ta përdorë biberonin vetëm deri në moshën 3 vjeç.

Të ushqyerit e shëndetshëm dhe diçka për «të kafshuar» ndërmjet dhëmbëve janë të rëndësishme.



## A e keni ditur se ...

të folurit e të luajturit e përditshëm së bashku sjell përparime të mëdha në zhvillimin gjuhësor?

# 8. A do të luash me mua?

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë fakt?

- Sa më shumë që të merreni me fëmijën tuaj, të flisni dhe të luani me të, aq më shumë struktura dhe ndërlidhje mund të ndërtohen në trurin e tij. Këto struktura dhe ndërlidhje janë vendimtare për zhvillimin gjuhësor të fëmijës dhe për të nxënit e mëvonshëm në shkollë.
- Të dëgjuarit dhe të folurit rregullisht në një gjuhë, ose në disa të tilla, e ndihmon fëmijën të zbulojë rregullat e këtyre gjuhëve. Fëmija mund të mësojë kështu fjalë, të zbulojë dhe të mësojë gramatikën e gjuhës, të komunikojë me të tjerët në mënyrë të saktë. Në secilën gjuhë ai ka nevojë për shumë «ushqim» dhe prandaj duhet të ketë mundësinë të dëgjojë dhe të flasë edhe vetë shumë.

# Këshilla për jetën e përditshme


## Çfarë mund të bëni konkretisht për fëmijën tuaj:

Kur flisni apo luani me fëmijën tuaj, qëndroni në një nivel të barabartë të syve! I flisni direkt fëmijës ose flisni direkt me të – të paktën një çerek ore në ditë!

Flisni me të edhe gjatë aktiviteteve të përditshme – p.sh. kur zhvesh këpucët dhe xhakaventon, kur vesh papuçet, kur i jepni një çaj, kur shkon në shtrat, ... Nuk mjaftojnë vetëm udhëzimet dhe urdhrat!

**Përdorni një gjuhë të pasur e të larmishme.  
Kështu fëmija juaj mund ta zgjerojë fjalorin.  
(Për shembull, duke përdorur fjalë të ndryshme për të njëjtën përmbajtje: i bukur, i këndshëm, i hijshëm, ...)**

Vjershat dhe këngët për fëmijët e çdo moshe janë një burim i mrekullueshëm për zhvillimin e pasurisë së tij shprehëse gjuhësore. Në rast se nuk i kujtoni dot më këngët dhe vjershat e fëmijërisë tuaj, atëherë pyesni prindërit tuaj ose pjesëtarët më të moshuar të familjes ose i lexoni nga një libër. Ose sajoni edhe vetë vjersha e tregime.



## A e keni ditur se ...

një fëmijë nuk duhet ta korrighosh pa pushim ose të kërkosh prej tij ta përsërisë një fjalë?

# 9. Thjesht më lër të flas!

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë fakt?

- Korrighimi ndrydh dëshirën për të folur. Teknika me efekt më të plotë është «përsëritja e përmirësuar».
- Fëmijët nuk tregojnë gjithmonë gjithçka çfarë dinë të bëjnë. Shpesh ata kuptojnë shumë, por akoma flasin pak. Fëmijët kanë nevojë për kohë, ashtu siç duan kohë edhe farat, që të mund të mbijnë.
- Kur fëmijët rriten me dy gjuhë, atëherë njëra gjuhë mund të shquhet më fort se sa tjetra. Në rrjedhën e jetës kjo gjë mund të ndryshojë herë pas here, varësisht se çfarë është e rëndësishme në atë fazë të jetës dhe me cilën gjuhë janë të lidhura përjetimet. Kështu, për shembull, tek fëmijët dygjuhësh, në kohën kur ndjekin kopshtin gjermanofolës dhe kur shokët e tij gjermanofolës bëhen më të rëndësishëm, mund të ndodhë që gjuha jogjermane e nënës të kalojë paksa në plan të dytë.

# Këshilla për jetën e përditshme

## Çfarë mund të bëni konkretisht për fëmijën tuaj:

Kur fëmija juaj shqipton diçka gabim, e përsërisni në formën e duhur fjalën ose fjalinë «pa rënë në sy». Mos e detyroni që ai ta përsërisë të saktë.

Ruani qetësinë kur fëmija nuk e përdor menjëherë një fjalë të re.

## Bëni durim! Flisni me fëmijën në gjuhën tuaj, edhe nëse ju përgjigjet në gjuhën tjetër.

Kur një fëmijë rritet me dy gjuhë, mund të ndodhë që njërën nga të dyja gjuhët, mbase edhe për një kohë të gjatë, nuk dëshiron ta përdorë në mënyrë aktive.

Kur fëmija është në një fazë të tillë, atëherë mos ushtroni shtypje, por i krijoni raste të shumta, që t'i përdorë në mënyrë aktive të dyja gjuhët.

## A e keni ditur se ...

leximi me zë dhe të folurit rreth tekstit janë forma shumë të rëndësishme të nxitjes gjuhësore dhe për fëmijën tuaj janë një parapërgatitje e mirë për shkollë?

# 10. A do të ma lexosh sot tregimin edhe më tutje?

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë fakt?

- Studimet shkencore tregojnë, se leximi ndikon qysh në vitet e para të jetës pozitivisht në zhvillimin gjuhësor të fëmijëve.
- Leximi dhe tregimi i asaj që është lexuar e zgjerojnë fjalorin e fëmijës. Ato krijojnë një bazë të mirë për leximin dhe shkrimin, sepse gjuha e shkruar është ndryshe nga gjuha e folur, dhe gjatë leximit me zë fëmija fiton përvojë me gjuhën e shkruar dhe e mëson atë.
- Fëmijët që dëgjojnë tregime dhe mund t'i ritregojnë ato, mësojnë në këtë rast shumë gjëra që do t'u vlejné më vonë në shkollë: për shembull që të mund të dëgjojnë kur flasin të tjerët, të përquendohen, të kujtojnë ngjarje, fjalë të reja, modele të reja fjalish dhe shumë të tjera.

# Këshilla për jetën e përditshme

## Çfarë mund të bëni konkretisht për fëmijën tuaj:

Lexojini fëmijës tuaj nga librat me figura dhe librat me tregime – çdo ditë diçka; në gjuhën, respektivisht në gjuhët, në të cilat flisni me fëmijën tuaj në shtëpi.

**Në një numër të madh bibliotekash mund të merrni libra me figura dhe me tregime në gjuhë të ndryshme. Pyesni në bibliotekën e vendbanimit tuaj nëse ka libra në gjuhën tuaj amtare.**

Fëmijët i duan ritualet! Fëmija i juaj nuk përjashtohet. Tregimet para gjumit mund të marrin formën e një rituali. Fëmijët kanë dëshirë të dëgjojnë herë pas here të njëjtin tregim, deri sa t'i kuptojnë si duhet të gjitha dhe të mund t'i ritregojnë. Ndhimoheni fëmijën tuaj që të mund ta ritregojë tregimin: për shembull përmes pyetjeve motivuese.

Edhe nëse nuk dini akoma shumë mirë gjermanisht, megjithatë ndoshta mund t'i lexoni fëmijës tuaj diçka nga librat me figura në gjuhën gjermane.

Edhe gjyshërit dhe persona të tjerë të besueshëm janë dëgjues dhe rrëfyes të mirë tregimesh.

## **A e keni ditur se ...**

fëmijët mësojnë më së miri nga loja dhe aktivitetet e përbashkëta, dhe jo nga shikimi i televizorit ose nga kompjuteri?

# **11. Të shohësh televizor? Jo faleminderit! Shumë më mirë kur babi dhe mami luajnë bashkë me mua!**

## **Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë fakt?**

- Për të mësuar gjuhën, fëmijët duhet, jo vetëm të dëgjojnë tingujt gjuhësorë, por edhe të kuptojnë domethënien e asaj që thuhet: Atë që shohin ta «kapin».
- Fëmija mëson të flasë vetëm në kontakt direkt me të tjerët: me nënën dhe me babain, me vëllezërit dhe motrat, në familjet më të mëdha, ndërsa më vonë me shoqet dhe shokët.
- Janë të këshillueshëm filmat e mirë për fëmijë, që shikohen së bashku me prindërit. Janë të dëmshme, ndërkaq, shikimi i televizorit ose loja në kompjuter për orë të tëra. Në këto raste fëmijët mësojnë pak.

# Këshilla për jetën e përditshme

## Çfarë mund të bëni konkretisht për fëmijën tuaj:

Lëreni fëmijën tuaj të ketë pjesën e vet në ngjarjet e përditshme.

Jepini atij rastin, që fjalët e reja t'i perceptojë me duar. Ndhima gjatë gatimit dhe pjekjes, loja me ujë, rërë dhe gurë ose plastelinë, janë më të përshtatshme se televizori për të përkrahur zhvillimin e fëmijës.

**Kur fëmija i juaj do të shikojë televizor, atëherë duhet të zgjidhni ju filmin dhe të flisni me fëmijën për atë çfarë ka parë. Kështu fëmija kupton më mirë dhe mëson edhe fjalë të reja.**

Shumë lojëra të mira mund të huazoni nëpër ludo-teka. Kështu mund t'i krijoni fëmijës suaj variacione dhe ngacmime të reja vetëm me pak para.



## A e keni ditur se ...

fëmijët mund të mësojnë shumë mirë gjermanisht, në rast se ata qysh herët e kanë një shoqe apo një shok me këtë gjuhë ose shkollën në kopsht ose në grupin e lojërave?

# 12. Unë dëshiroj të jem bashkë edhe me fëmijët e tjerë!

## Çfarë thonë ekspertët dhe ekspertet për këtë fakt?

- Njohuritë e mira të gjermanishtes janë të rëndësishme për fëmijën tuaj: për jetën e tij, për të shkuar me dëshirë në shkollë dhe për të pasur shanse të mira në fushën e profesionit.
- Për të mësuar mirë gjermanisht, fëmija juaj ka nevojë për motivim dhe mundësi të shumëllojshme që ta dëgjojë dhe ta flasë këtë gjuhë. Shoqet dhe shokët, që flasin mirë gjermanisht, janë një motivim shumë i mirë.
- Ndjekja e rregullt e një grupi të lojërave ose e kopshtit që nga mosha tre-vjeçare i jep kohë fëmijës që ta forcojë gjuhën gjermane deri në fillimin e shkollës dhe që të parapërgatitet për kërkesat e shkollës. Edhe nëse gjuha e tij familjare nuk është gjermanishtja, fëmija mund ta mësojë këtë gjuhë shumë mirë, në rast se e shfrytëzon këtë mundësi.

# Këshilla për jetën e përditshme

## Çfarë mund të bëni konkretisht për fëmijën tuaj:

Përkraheni fëmijën tuaj, kur dëshiron të vizitojë ose të ftojë në shtëpi shoqe dhe shokë. Gjuhët që për ta janë të rëndësishme në jetën e përditshme, fëmijët zakonisht i mësojnë shumë shpejt.

Regjistrojeni fëmijën tuaj që në moshën dy e gjysmë deri në tre vjeç në një grup lojërash. Fëmijët në këtë moshë në shumicën e rasteve janë mjaft të pjekur për këtë gjë dhe gëzohen për shoqet dhe shokët e rinj si edhe për lojërat dhe aktivitetet me fëmijët e tjerë.

**Është i mundshëm edhe vizitimi më herët i një institucioni të përkujdesjes për fëmijë, në rast se e keni të nevojshme këtë gjë për shkak të profesionit ose keni vendosur duke u nisur nga arsyetime pedagogjike.**

Nëse ju në shtëpi flisni me fëmijën tuaj në një gjuhë të ndryshme nga gjermanishtja, mund ta parapërgatisni fëmijën si duke luajtur për gjermanishten, si një gjuhë të re, që ai do ta njohë në grupin e lojërave ose në kopsht. Flisni me fëmijën për këtë gjë, bëjeni kureshtar, mësojini atij nocione të thjeshta, të cilat mund t'i duhen në mjedisin e tij të ri.

**Transmetojani fëmijës, se është një gjë e mrekullueshme fakti, që ai mund të flasë disa gjuhë.**

## Edhe diçka që e kemi për zemër ...

Gjuhët, për të cilat ne nuk investojmë, humbasin. Për të mos e harruar, duhet që një gjuhë ta kultivojmë dhe ta përdorim.

Kur fëmija juaj do të shkojë në kopsht, dhe më vonë në shkollë, gjermanishtja do të bëhet një gjuhë e rëndësishme për të. Për këtë gjë ka nevojë për nxitjen dhe përkrahjen tuaj. Por mos harroni të kultivoni gjuhën tuaj ose gjuhën e familjes tuaj.

Në shkollë mësimi në gjuhën dhe kulturën e atdheut (HSK) është një mundësi e mirë për ta nxitur më tutje gjuhën e parë. Informohuni për këtë dhe regjistroni fëmijën tuaj aty.

Lexoni ju vetë gazeta dhe/ose libra dhe flisni me fëmijën tuaj mbi temat e reja! Kështu ju dhe fëmija i zhvilloni më tej gjuhët tuaja.

Motivoheni fëmijën tuaj të lexojë shumë – në gjermanisht dhe në gjuhët e tjera.

Gjuha – secila gjuhë, është një thesar. Vlera e tyre rritet, sa më shumë që të zhvillohen dhe të kultivohen ato. Sot zotërimi i mirë i gjuhëve është vendimtar për pozicionin e një njeriu në fushën e profesionit dhe në shoqëri.

Gjuha amtare e emigrantëve dhe migrantëve në St.Gallen – shqipja, boshnjakishtja/kroatishtja/serbishtja, italishtja, turqishtja, portugalishtja, tamilishtja dhe shumë të tjera – në ekonominë e globalizuar po kërkohen gjithnjë e më shumë. Po të zotërojnë mirë edhe ndonjë gjuhë tjetër krahas gjuhës gjermane, kjo do t'i sjellë fëmijës tuaj shanse në profesion.

# Institucionet dhe ofertat për këshillim dhe mbështetje të prindërve në St.Gallen

## **Gemeinde (Komuna)**

Informacionet për përkujdesjen për fëmijë, grupet e lojërave dhe kopshtet e fëmijëve në vendbanimin tuaj do t'i merrni në bashkinë tuaj.

## **Ostschweizer Verein für das Kind**

Shoqata për fëmijë e Zvicrës Lindore mbështet mirëqenien dhe shëndetin e fëmijëve duke u fokusuar në këshillimin dhe shoqërimin e prindërve me fëmijë të moshës parashkollore. Në këshillimorën për prindër mund t'i bisedoni të gjitha çështjet që lidhen me shëndetin, ushqimin, zhvillimin dhe edukimin e foshnjës dhe fëmijës suaj të vogël.

Përpos kësaj, ekziston mundësia që të lidhni kontakte me prindër të tjerë.

[www.ovk.ch](http://www.ovk.ch)

## **Orë bisedimore për fëmijë të moshave midis 0 dhe 3 vjeç**

Prindërit që brengosen për zhvillimin e fëmijës së tyre të vogël apo për sjelljet e tij, mund t'i drejtohen kësaj qendre kontaktimi. Këtu do të sqarohen nevojat e fëmijëve dhe do të gjenden e përpunohen zgjidhje të reja.

[www.kjpd-sg.ch](http://www.kjpd-sg.ch)

## **Kinderschutzzentrum St.Gallen**

### **(Qendra për mbrojtjen e fëmijëve St.Gallen)**

Prindërit që ndjehen të mbingarkuar me fëmijët e vegjël dhe që arrijnë pikën ekstreme, mund t'i drejtohen Linjës kujdestare TATKRÄFTIG. Oferta

e Qendrës për mbrojtjen e fëmijëve St.Gallen i këshillon të prekurit në mënyrë anonime, falas dhe në konfidencë.

[www.tatkraeftig.ch](http://www.tatkraeftig.ch)

## **Erziehungsberatung (Këshillim për edukimin)**

Qendrat e këshillimit për familjet ju përkrahin në sqarimin e pyetjeve në lidhje me edukimin dhe ju ndihmojnë për të gjetur zgjidhje në situatat e vështira – si p.sh. në rastet e frikës, hiperaktivitetit, grindjes mes vëllezërve dhe motrave, problemeve me bashkëmohatarët.

[www.sozialberatung.sg.ch](http://www.sozialberatung.sg.ch)

## **Schulpsychologische Dienste**

Shërbimet shkollore psikologjike janë në dispozicionin tuaj në rast se keni paqartësi në çështjet psikologjike që ndërlidhen me probleme shkollore dhe/ose edukative.

[www.schulpsychologie-sg.ch](http://www.schulpsychologie-sg.ch) (Kantoni St.Gallen)

[www.schulgesundheits.stadt.sg](http://www.schulgesundheits.stadt.sg) (Qyteti St.Gallen)

## **Bibliotekat und ludotekat**

Biblioteka dhe ludoteka për huazimin e librave dhe lojrave për fëmijë ju mund të gjeni në shumë vende. Gjithnjë e më shumë biblioteka kanë libra në disa gjuhë në ofertat e tyre, siç është për shembull Biblioteka Interkulturore në kuadër të Freihandbibliothek në qytetin e St.Gallenit.

[www.freihandbibliothek.ch](http://www.freihandbibliothek.ch)

[www.ludosg.ch](http://www.ludosg.ch)

## Impressum

Botuesi	Kompetenzzentrum Integration und Gleichstellung Departement des Innern des Kantons St.Gallen  E drejta për përdorim dhe adoptim për kantonin e St. Gallenit: Kompetenzzentrum Integration und Gleichstellung, Departement des Innern Adaptim dhe redaktim teksti: Kathrin Wirz
Gjuhët	Gjermanisht – shqip, boshnjakisht/kroatisht/serbisht, anglisht, frengjisht, italisht, portugalisht, spanjisht, tamilisht, tigrinisht, turqisht
Përkthimi/Layouti	<a href="http://www.alscher.ch">www.alscher.ch</a>
Shtypi	Tschudy Druck AG, St.Gallen
Porosia	Departement des Innern Kompetenzzentrum Integration und Gleichstellung Regierungsgebäude 9001 St.Gallen <a href="mailto:info.kig@sg.ch">info.kig@sg.ch</a>
Shkarkimi	<a href="http://www.integration.sg.ch">www.integration.sg.ch</a>

St.Gallen, Janar 2014

## Ideja dhe koncepti

Lënda thelbësore e kësaj broshure është zhvilluar në kuadër të programit «më shumë gjuhë. Nxitja e hershme e gjuhës dhe e shumëgjuhësisë – një sfidë për familjet dhe institucionet e arsimit të hershëm», sipas kërkesës së Landit Vorarlberg.

Informacionet rreth programit nën [www.okay-line.at](http://www.okay-line.at)

Bazat përmbytësore	Elisabeth Allgäuer-Hackl, Gerlinde Sammer, Elizabet Hintner
Teksti	Elisabeth Allgäuer-Hackl, Lidwina Boso
Redaktimi	Eva Grabherr

© okay. zusammen leben / Projektstelle für Zuwanderung und Integration, Vorarlberg (Verein Aktion Mitarbeit), Dornbirn (Österreich) November 2010